

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	IuteCredit gllabëron 6.5 milionë euro nën hundën e tatimeve? Zbardhet skema e pagesave drejt Estonisë
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/iutecredit-i-shpeton-tatimeve-ne-shqiperi-rriten-me-114-mln-euro-tran-i46551
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:48:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ecc9aefd78d5e6f4a082d4a0c7b5cf9b4cee87277b265e86fc18ff3b57ce3632
TEKSTI	d2282045536dd40d0ee86726d09760087aa7ee1e2da077028615eaced9baf66
PAMJA	8bde9f88a43bb8195c9bfe3364a4221f30ec676bcbabeb09f8db537bb0eab51de

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	32a8d2006e956b71e9b01dd27fed4f82a1e82051ae97bf2026c7820b3cb9ce77
E MËPARSHMJA	b8c802a5b2e87600ee85209ab7cfe75d8d513160f94a16110dfe6a1929c0c07f
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/32a8d2006e956b71e9b01dd27fed4f82a1e82051ae97bf2026c7820b3cb9ce77>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

[Pas helmimit nga Tirana në Kukës me pulë me salmonelë, 'A.M.G shpk' e Mondi Goxhes kapet me 2 mln € kokainë në Portin e Durrësit](#)

14 Shtator 2026, 14:29

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 14 Shtator 2026, 18:44

IuteCredit gllabëron 6.5 milionë euro nën hundën e tatimeve? Zbardhet skema e pagesave drejt Estonisë

Në harkun e pesë viteve, shpenzimet e deklaruar ndaj kompanisë mëmë janë rritur me gati tre herë



Shkruar nga Veritas



IuteCredit Albania ka paguar gjatë vitit të kaluar rreth 1.1 miliardë lekë, ose 11.4 milionë euro, shpenzime për kompaninë e saj mëmë në Estoni. Shifrat dalin nga bilanci zyrtar i kompanisë dhe përfshijnë pagesa për shërbime menaxhimi, shërbime garancie dhe interesa borxhi.

Të dhënat financiare tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti i IuteCredit në Shqipëri është kanalizuar drejt kompanisë mëmë përmes këtyre transaksioneve.

Nga totali prej 1.1 miliardë lekësh, 605.5 milionë lekë janë paguar për shërbime menaxhimi nga kompania mëmë në Estoni.

Një tjetër zë i rëndësishëm janë 219 milionë lekët e paguara për shërbime garancie.

Ndërsa pjesa e mbetur, prej 274.3 milionë lekësh, përbëhet nga interesa që IuteCredit Albania i paguan pronarit estonez si interesa për borxhin.

Në total, këto pagesa arrijnë në rreth 11.4 milionë euro vetëm për një vit.

Si zbrazet fitimi nga Shqipëria?

Në një sistem ideal taksimi, ku kapitali do të tatohej njësoj pavarësisht kufijve, transaksionet e një kompanie me palët e lidhura nuk do të përbënin ndonjë shqetësim të madh.

Por në botën reale, problemi qëndron pikërisht te fakti se shkalla e taksave ndryshon nga njëri vend në tjetrin.

Në Shqipëri, tatimi mbi fitimin është 15 për qind.

Në Estoni, ndërkohë, sistemi tatimor është i ndryshëm dhe fitimet e pashpërndara nuk taten në të njëjtën mënyrë si në Shqipëri.

Ky hendek tatimor krijon mundësi për atë që njihet si arbitrazh tatimor.

Nëpërmjet transaksioneve mes palëve të lidhura, një kompani mund të lëvizë një pjesë të fitimit nga vendi ku aktiviteti ekonomik zhvillohet dhe ku fitimi tatohet, drejt një juridiksioni ku barra tatimore është më e ulët.

Kjo është pikërisht ajo që ngre pikëpyetjet në rastin e IuteCredit në Shqipëri.

Kompania shqiptare paguan shumë të konsiderueshme ndaj kompanisë mëmë për menaxhim, garanci dhe interesa borxhi. Këto pagesa regjistrohen si shpenzime në Shqipëri dhe ndikojnë në rezultatin financiar të kompanisë.

Sa më të larta të jenë shpenzimet e deklaruara, aq më i ulët mund të jetë fitimi që mbetet për t'u tatuar në Shqipëri.

Në këtë mënyrë, debati nuk lidhet vetëm me shumën që transferohet jashtë vendit, por edhe me efektin që këto pagesa kanë mbi bazën e tatueshme të kompanisë.

Në pesë vitet e fundit, shpenzimet që Iute Albania bën për kompaninë e saj mëmë në Estoni gati janë trefishuar.

Në vitin 2020, këto shpenzime ishin rreth 3.96 milionë euro.

Vitin e kaluar, shifra arriti në 11.4 milionë euro.

Pra, brenda një periudhe prej pesë vitesh, pagesat ndaj kompanisë mëmë janë rritur me rreth 7.4 milionë euro.

Rritja është e ndjeshme dhe tregon një zgjerim të fortë të fluksit financiar nga kompania shqiptare drejt pronarit të saj në Estoni. Pikërisht këtu hyn në lojë administrata tatimore.

Kur një kompani shqiptare kryen pagesa të konsiderueshme ndaj një kompanie të lidhur jashtë vendit, administrata tatimore ka mundësinë të kontrollojë natyrën e këtyre transaksioneve dhe mënyrën se si ato ndikojnë në fitimin e tatueshëm.

Në qendër të kontrollit janë rregullat e transferimit të çmimeve.

Parimi është që kompanitë e lidhura duhet të kryejnë transaksione me kushte të krahasueshme me ato që do të zbatoheshin mes kompanive të pavarura.

Pra, pyetja është nëse 605.5 milionë lekët për menaxhim, 219 milionë lekët për garanci dhe 274.3 milionë lekët interesa përfaqësojnë vlera të arsyeshme dhe të justifikueshme sipas kushteve të tregut.

Nëse po, atëherë bëhet fjalë për shpenzime që janë pjesë e marrëdhënieve normale financiare të grupit.

Nëse jo, atëherë lind pyetja nëse këto pagesa kanë ndikuar në mënyrë artificiale në uljen e fitimit të deklaruar në Shqipëri.

A po largohet fitimi nga Shqipëria?

Thelbi i gjithë çështjes është i thjeshtë: sa fitim krijon IuteCredit në Shqipëri dhe sa prej tij mbetet këtu pasi zbriten pagesat ndaj kompanisë mëmë?

Nëse një pjesë e madhe e fitimit përdoret për të paguar shërbime, garanci dhe interesa ndaj pronarit jashtë vendit, atëherë natyrshëm lind pyetja se sa është fitimi real që mbetet për t'u tatuar në Shqipëri.

Në një ekonomi ku kompanitë ndërkombëtare veprojnë përmes strukturave të ndryshme juridike, transferimi i fitimeve dhe optimizimi tatimor janë çështje që monitorohen nga autoritetet fiskale në të gjithë botën.

Por kur diferencat mes regjimeve tatimore janë të mëdha, rreziku i zhvendosjes së fitimeve bëhet një çështje edhe më e rëndësishme.

Në rastin e IuteCredit, bilanci tregon një rritje të ndjeshme të pagesave ndaj kompanisë mëmë në Estoni, nga 3.96 milionë euro në vitin 2020 në 11.4 milionë euro vitin e kaluar.

Kjo është një rritje prej gati tre herësh në pesë vite.

Dhe pikërisht këtu qëndron pyetja që mbetet për administratën tatimore: a janë këto pagesa në përputhje me vlerën reale të shërbimeve dhe me parimin e çmimit të tregut, apo përmes tyre po zhvendoset një pjesë e fitimit të krijuar në Shqipëri drejt Estonisë?

Shifrat janë në bilanc. 1.1 miliardë lekë ose 11.4 milionë euro pagesa ndaj kompanisë mëmë vetëm gjatë vitit të kaluar, kundrejt 3.96 milionë eurove pesë vite më parë.

Një rritje që e vendos në qendër të vëmendjes jo vetëm aktivitetin financiar të IuteCredit Albania, por edhe mënyrën se si kontrollohen transaksionet mes kompanive të lidhura dhe nëse Shqipëria po merr pjesën e saj të detyrimeve tatimore nga fitimet e krijuara brenda vendit./Versus.al

Poll



AKTUALITET

[Kosova drejt një krize të re politike? Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për President](#)

14 Shtator 2026, 19:01

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Polici goditi protestuesin gjatë tubimit sot në Tiranë, Hita pezullon nga detyra efektivin](#)

14 Shtator 2026, 18:27

^ekstrakti^



AKTUALITET

[PDK konteston qeverinë “Kurti 4” në Kushtetuese](#)

14 Shtator 2026, 17:55

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Rregullorja e re e GJKKO-së shkon në Kushtetuese, shoqata e gazetarëve: Cenon të drejtën e informimit](#)

14 Shtator 2026, 17:27

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Meta dhe Veliaj kërkojnë lirinë, nesër 2 seanca në GJKKO për ish-presidentin dhe kryebashkiakun e Tiranës](#)

14 Shtator 2026, 16:57

^ekstrakti^



AKTUALITET

[U kërcënua me vdekje me mesazh, gazetari Osman Stafa bën padi në polici, nisin hetimet](#)

14 Shtator 2026, 16:19

^ekstrakti^





AKTUALITET

Elbasan, 18 vjeçari përplas për vdekje me makinë të moshuarin që lëvizte me biçikletë

14 Shtator 2026, 15:30

^ekstrakti^



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.